



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLA.nr.17/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR], me vendbanim në Zvicër, të parashtruar ndaj vendimit të KQZ-së, me nr. Protokolli 01/2318-2025, të datës 03.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Refuzimin e Kundërshtimit Administrativ, në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.09.2025, mori këtë :

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ANKESA e parashtruar nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, mbetet në fuqi vendimi i KQZ-së me nr. 01/2318-2025 datë 03.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Refuzimin e Kundërshtimit Administrativ, në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

Arsyetim

Më datë 05.09.2025 në ora 20:22, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se me datë 03.09.2025, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka refuzuar kundërshtimin administrativ me arsyetimin se adresa e tij nuk është vërtetuar.

Më tej në ankesë theksohet se ky vendim është i pabazuar sepse parashtruesi i ankesës ka ofruar prova të mjaftueshme për adresën e tij aktuale jashtë Kosovës, e cila është e plotë dhe e verifikueshme.

Sipas parashtruesit të ankesës e drejta e tij për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës është e garantuar me Ligjin Nr08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme. Refuzimi i vetëm mbi bazën formale të adresës cenon këtë të drejtë. Dokumentet e tij të paraqitura përfshijnë të dhëna të karta dhe të sakta mbi adresën e të njëjtit leja e qarkullimit të automjetit të bashkëngjitur përmban emrin, mbiemrin dhe adresën në Zvicër, duke dëshmuar në mënyrë të pakontestueshme vendbanimin e tij. Kjo provë është e mjaftueshme për të plotësuar kriterin e verifikimit të adresës, prandaj vendimi i KQZ-së është i gabuar dhe duhet të anulohet.

Kërkon nga PZAP-i, që të pranoj ankesën si të bazuar, të anulojë vendimin e KQZ-së Nr. 01/2318-2025, të datës 03.09.2025, dhe të obligojë KQZ-në të pranojë regjistrimin e tij si votues jashtë Kosovës, duke marrë parasysh provat e paraqitura mbi adresën e tij.

Ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi kopjen e Vendimit të KQZ-së, nr.01/2318-2025, datë 03.09.2025, dhe kopjen e Lejes së Qarkullimit të Automjetit.

Në përgjigje në kërkesë KQZ, sqaron se në mbledhjen e datës 3 Shtator 2025, e mbajtur me fillim në orën 11:00, KQZ-ja, ka marrë vendim për miratimin e rekomandimeve të Komisionit për Kundërshtim Administrativ i formuar nga KQZ-ja me qëllim të trajtimit të ankesave të aplikuesve që u refuzohet aplikimi për regjistrim. Në mesin e këtyre rekomandimeve, KQZ-ja ka miratuar edhe refuzimin e kundërshtimit administrativ për 174 aplikues.

Më tej KQZ-ja thekson se [redacted] është informuar për vendimin e refuzimit të kundërshtimit administrativ Nr.01/2318-2025 të datës 03.09.2025, në ora 17:03. PZAP ka pranuar ankesë më datë 05.09.2025, në ora 20:22. Sipas vendimit të KQZ-së nr. 01/2318-2025, të datës 03.09.2025, palët kanë të drejtë ankese në PZAP brenda 48 orëve nga momenti i pranimi të vendimit të KQZ-së. Andaj, konsiderojnë se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

Bashkangjitur në përgjigje janë : rendi i ditës për mbledhjen e KQZ-së, të datës 3 Shtator 2025, ora 11:00, rekomandimin nr.02/4-2314-2025 të datës 03.09.2025, e Komisionit për Kundërshtim e Administrativ për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2025, njoftimin e dërguar nga KQZ-ja palës ankuese me datë 03.09.2025 ora 17:03, Vendimin e KQZ-së Nr.01/2318-2025 të datës 03.09.2025, për miratimin Rekomandimit për Refuzimin e Kundërshtimit administrativë.

Paneli, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës konstatoi se:

-Ankesa e parashtruar nga Nuard Buzhala është e pasafatshme.

Paneli, konstatoi se ankesa e parashtruar nga [redacted] me vendbanim në Zvicër, është e pasafatshme sepse në bazë të nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.3 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, ndaj vendimit të KQZ-së, për Miratimin Rekomandimit për Refuzimin e Kundërshtimit Administrativ, në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, afati për të parashtruar ankesë në PZAP, është 48 orë, nga momenti i pranimi të vendimit nga pala e interesuar.

Në nenin 98 par.3 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ndër të tjera thuhet se *“Çdo aplikues të cilit i është refuzuar kundërshtimi administrativ ka të drejtë ankese në PZAP brenda (48) orëve nga pranimi i vendimit...”*.

Pala ankuese vendimin e KQZ-së e ka pranuar me datë 03.09.2025 në ora 17:03, dhe i njëjti ka parashtruar ankesë në PZAP, me datë 05.09.2025 në ora 20:22, nga kjo del se ankesa është e pasafatshme ngase kanë kaluar më shumë se 3 orë nga afati prej 48 orësh nga momenti i pranimi të vendimit të KQZ-së.

Prandaj, Paneli nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në nenin 98 par.3 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në dispozitat e nenit 115 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 7 paragrafi 6 i Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, si dhe në bazë nenit 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr. 17/2025 më datën 09.09.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.